



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:195111

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05733149

**C.nr.1381/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni civil**, me gjyqtarin Shyqri Hoxha dhe bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.B. nga fshati .... komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson I.Xh.K. avokate nga Suhareka, kundër të paditurve B.R. nga Prizreni, dhe F.H. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit material, dëmit jo material dhe fitimit të humbur, vlera e kontestit 79,496.08 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor - publik, në prani të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të të paditurve, me datë 22 prill 2024 mori, ndërsa më datë 24 maj 2024, përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit S.B. nga fshati .... komuna e Suharekës, me të cilën kanë kërkuar që të *“OBLIGOHEN të paditurit B.R. dhe F.H. që në mënyrë solidare që në emër të dëmit jomaterial, për dhimbje shpirtërore, ti paguaj paditësit shumën prej 10,000 euro, ndërsa në emër të fitimit të humbur shumën prej 69,496.08 euro, apo gjithsej 79,496.08 euro”*, **në tërësi si e pabazuar**.
- II. **KONSTATOHET** e tërhequr padia e paditësit S.B. nga fshati .... komuna e Suharekës ndaj të paditurit V.R. nga Prizreni.
- III. **DETYROHET** paditësi S.B. nga fshati ..... komuna e Suharekës, që në emër të shpenzime procedurale të ia paguan të paditurit V.R. nga Prizreni, shumën prej 956.80 € (nëntë qind e pesëdhjetë e gjashtë euro, e tetëdhjetë cent), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas ditës së plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë

**A r s y e t i m**

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi S.B. nga fshati ..... komuna e Suharekës, përmes të autorizuarës së tij, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me datën 05.09.2019, të cilën e ka precizuar me parashtresën e datës 17.10.2023, kundër të paditurve B.R. dhe F.H. të dy nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit material, dëmit jo material dhe fitimit të humbur, vlera e kontestit 79,496.08 €.

Në padinë e paraqitur e autorizuar e paditësit ka theksuar se paditësi kishte lidhur marrëveshje me MNP "Personal Leasing", me përfaqësues B.R. me anë të së cilës i padituri ka marrë përsipër që të bëj rregullimin dhe kompletimin e dokumentacionit për vizë pune në Gjermani. Për këtë marrëveshje paditësi kishte paguar shumën prej 2,500 euro, me datë 03.12.2016, ndërsa me datë 04.08.2017, paditësi kishte nënshkruar kontratën për punë me kompaninë gjermane CAPAR Spezialtiefbau GmbH, ku sipas kësaj marrëveshje paditësi për punën të cilën do ta kryente do të paguhej 14.70 euro për orë, përkatësisht muaji do ti paguhej 2,587 euro. Sipas marrëveshjes të hollat do të ktheheshin nga ana e kompanisë nëse nuk kompletohet dokumentacioni nga ana e MNP "Personal Leasing", si dhe nëse kompania gjermane nuk plotëson kushtet për pranimin e punëtorëve në punë, ndërsa viza për punësim është refuzuar nga ambasada Gjermane, me arsyetimin se nuk është plotësuar dokumentacioni, konkretisht mungon garancioni për punë nga ana e Kompanisë Gjermane. Pas refuzimit të vizës, paditësi ka kërkuar nga e paditura kthimin e mjeteve në emër të pagesës për rregullimin e dokumentacionit për vizë në Gjermani, mirëpo e njëjta nuk i është përgjigjur asnjëherë, duke i ikur kontaktit me paditësin, e kështu paditësin jo vetëm që e kanë dëmtuar materialisht duke e mashtruar dhe marrë para në vlerë prej 2,500 euro, por të njëjtin e kanë dëmtuar edhe në aspektin moral, psikologjik, sepse paditësi S.B. ka pasur fitim të humbur sipas kontratës së lartcekur në latësi prej 62,088 euro. Andaj, gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

E autorizuar e paditësve edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë dhe precizimeve të bëra, ndërsa në fjalën përfundimtare të e autorizuar e paditësit ka deklaruar se në këtë procedurë bazuar në të gjitha provat të cilat janë administruar, është vërtetuar fakti se kërkesëpadia e paditësit S.B. është në tersi e bazuar dhe në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga ana e të paditurave, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovoj si të bazuar në tersi, ashtu që të obligohen të paditurit që në mënyrë solidare paditësit S.B. t'ia kompensojnë dëmin material dhe jomaterial, si dhe kompensimin në emër të fitimit të humbur shumën 79,496.08 euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe atë me kamat ligjore prej 8%, nga dita e paraqitja së padisë, deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar, ashtu si i ka specifikuar në fjalën përfundimtare.

I padituri i parë B.R. nga Prizreni, në këtë çështje juridike kontestimore nuk ka paraqitur përgjigje në padi, e po ashtu i njëjti nuk ka prezantuar pranë gjykatës gjatë shqyrtimit të kësaj çështje kontestimore. Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mungesë të tij, konform nenit 423 par.4 të LPK-së.

I padituri i dytë F.H. nga Prizreni, përmes përgjigjes në padi të datës 07.03.2022, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se kërkon që padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar, kjo pasi që i njëjti nuk është pronar i kompanisë në fjalë, duke theksuar se pronar i firmës është B.R.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale nuk ka prezantuar as i padituri i dytë F.H., komunikimi për të njëjtin është bërë përmes tabelës së shpalljeve të kësaj gjykate, konform nenit 116 par.5 dhe 6, pasi që i njëjti gjatë zhvillimit të procedurës e ka ndryshuar adresën e tij dhe për këtë nuk e ka njoftuar gjykatën.

## 2. Provat e administruara

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën për ndërmjetësim punësimi, të datës 03.12.2016; lejen në tregun e punës, e lëshuar nga Agjencia Federale e Punësimit Frankfurt/Main Republika Federale e Gjermanisë, e datës 08.08.2017; leximi i terminit me nr. 6954362, të datës 29.06.2017; leximi i kontratës së punës e lidhur në mes Capar Spezialtiefbau GmbH dhe Seb Bullakaj, e datës 04.08.2017; leximi i aplikacionit për vizë pranë Ambasadës Gjermane me datë 10.08.2017; leximi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren- Departamenti për Krime të Rënda, me nr. PKR.nr.66/2018, i datës 09.02.2020, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm në piken II të dispozitivit, sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, APS.nr.23/20; leximi i aktit përcjellës të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren, me nr. PKR.nr.66/2020, i datës 06.10.2020; leximi i Certifikatës së regjistrimit të biznesit e datës 13.12.2016, MNP Personal Lising Sh.p.k., me nr. të biznesit 71342077; leximi i certifikatës së datës 13.12.2016, deklaruesit të TVSH-së, për biznesin MNP Personal Lising Sh.p.k., leximi i informatës mbi biznesin e lëshuar me datën 13.12.2016, për biznesin MNP Personal Lising Sh.p.k.; leximi i aneks statutit të Sh.p.k., "Staff recruitment Balkan", i datës 13.03.2017; leximi i të dhënave nga ARBK, për biznesin "Staff recruitment Balkan"; shikimi në dy fotografi; leximi i pasqyrës bankare të lëshuar nga Raiffeisen Bank, në emër të "Staff recruitment Balkan", e lëshuar me datën 29.05.2017; leximi i ekspertizës mjeko ligjore nga lëmia e psikiatrisë, përpiluar nga eksperti Dr. N.F. e datës 02.06.2022; leximi i ekspertizës nga lëmia financiare e datës 23.03.2023, si dhe plotësimi i saj i datës 22.09.2023, e përpiluar nga eksperti H.B.

Gjykata pas vlerësimit të theksimeve të palëve dhe provave të administruara në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Nga leximi i kontratës për ndërmjetësim punësimi, të datës 03.12.2016, gjykata vërtetoi faktin se këtu paditësi S.B. kishte lidhur marrëveshje me MNP Personal Leasing, për ndërmjetësim të punës në Gjermani dhe se i njëjti kishte bërë pagesën e shumës në lartësi prej 2,500.00 euro. Qëllimi sipas kësaj marrëveshje ishte që këtu paditësi të pajiset me vizë pune.

Nga leximi i dokumentit i cili mban titullin - lejen në tregun e punës, e lëshuar nga Agjencia Federale e Punësimit Frankfurt/Main Republika Federale e Gjermanisë, e datës 08.08.2017, gjykata konstatoi faktin se sipas të njëjtit ishte dhënë miratimi mbi të drejtën e qëndrimit, me kusht që kërkesa në kuadër të procedurës së vizës rezulton të jetë pozitive. Miratimi i ishte nënshtruar kushtit që punësimi të kryhet sipas kushteve të punës që kanë qenë bazë e ekzaminimit me pagë të paktën 14,70 euro në orë dhe 40 orë në javë.

Nga leximi i terminit me nr. 6954362, të datës 29.06.2017, gjykata vërtetoi faktin se termini për kërkesën për vizë me qëllim të punësimit për këtu paditësin, në Ambasadën Gjermane në Prishtinë, ishte caktuar me datë 10.08.2017, në mes të orës 08:00 dhe 09:00.

Nga leximi i kontratës së punës e lidhur në mes Capar Spezialtiefbau GmbH dhe S.B. e datës 04.08.2017, gjykata konstatoi faktin se sipas kësaj kontrate si punëdhënës paraqitet Capar Spezialtiefbau GmbH, ndërsa i punësuar këtu paditësi S.B. Sipas kësaj kontrate palët ishin përcaktuar që punëmarrësi do të punësohet në Gjermani, si punëtor i kualifikuar ndërtimi. Paga bazë e përcaktuar në këtë kontratë ishte 14,70 euro për orë pune (më gjerësisht si në kontratën e lartcekur).

Nga leximi i aplikacionit për vizë pranë Ambasadës Gjermane me datë 10.08.2017, gjykata konstatoi faktin se i njëjti përmban të dhënat e këtu paditësit Seb Bullakaj.

Nga leximi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren- Departamenti për Krime të Rënda, me numër PKR.nr.66/2018, i datës 09.02.2020, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm në piken II të dispozitivit, sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, APS.nr.23/20, gjykata vërtetoi faktin se këtu të paditurit B.R. dhe F.H. ishin shpallur fajtor për veprat penale shpërlarje parash nga neni 308 i Kodit Penal, veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 lidhur me nenin 81 të Kodit Penal dhe i padituri F.H. edhe për veprën penale shmangie nga tatimi nga neni 313 par.3 të Kodit Penal të Kosovës, për të cilat vepra ishin dënuar me dënim me burg dhe me gjobë.

Nga leximi i aktit përcjellës të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren, me numër PKR.nr.66/2020, i datës 06.10.2020, gjykata vërtetoi faktin se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren- Departamenti për Krime të Rënda, me numër PKR.nr.66/2018, i

datës 09.02.2020, në piken II të dispozitivit, është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga data 22.07.2020, sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, APS.nr.23/20, për veprën penale të mashtrimit nga neni 335 par.2 dhe nenit 31 dhe 81 të KPRK-së, ndërsa në pikat tjera aktgjykimi nuk është i plotfuqishëm, ngase është kthyer në rigjykim.

Nga leximi i Certifikatës së regjistrimit të biznesit, të datës 13.12.2016, për biznesin me emër "MNP Personal Lising" Sh.P.K., me nr. të biznesit 71342077, gjykata vërtetoi faktin se ky biznes është i regjistruar si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me adresë në Prizren, rr. "Ismet Jashari Kumanova" nr.32.

Nga leximi i certifikatës së datës 13.12.2016, deklaruesit të TVSH-së, për biznesin MNP Personal Lising Sh.p.k. dhe i informatës mbi biznesin e lëshuar me datën 13.12.2016, për biznesin MNP Personal Lising Sh.P.K, gjykata konstatoi faktin se biznesi me numër 71342077, ishte regjistruar se deklarues i TVSH-së, me drejtor këtu të paditurin B.R. dhe se veprimtaria primare e këtij biznesi ishte Aktivitet i agjencive të punësimit.

Nga leximi i aneks statutit të Sh.P.K., "Staff recruitment Balkan", e datës 13.03.2017, gjykata konstatoi faktin se me këtë aneks status ishte rregulluar emërtimi i shoqërisë, ashtu që emërtimi i plotë i shoqërisë është "Staff Recruitment Balkan", shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me drejtor B.R.

Nga leximi i të dhënave nga ARBK, për biznesin "Staff recruitment Balkan", gjykata vërtetoi faktin se ky biznes ishte regjistruar si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me numër të biznesit 71342077, me datë 12.12.2016, në Prizren, rr. "....." me kapital 5,000.00 euro, dhe se aktivitet primar ishte Aktivitet i agjencive të punësimit.

Gjykata ka bërë shikimin në dy fotografi, në të cilat shihet në njëren foto shihet zyrja ku ka vepruar subjekti juridik MNP Personal leasing dhe në njëren foto ku shihet i padituri B.R. në cilësinë e drejtorit të këtij subjekti juridik, ku gjykata nga këto foto arriti ta vërtetoj faktin se ky subjekt juridik me drejtor të padituri B.R. përveq tjerave ka pas edhe dhënjën e shërbimeve për sigurimin e punës në afat kohore prej 3 vitësh në Gjermani.

Nga leximi i pasqyrës bankare të lëshuar nga Raiffeisen Bank, në emër të "Staff Recruitment Balkan", e lëshuar me datën 29.05.2017, gjykata ka konstatuar se në të njëjtën paraqitet pasqyra e xhirollogarisë bankare, për periudhën kohore nga data 01.12.2016 deri me datë 29.05.2017

Nga leximi i ekspertizës mjeko ligjore nga lëmia e psikiatrisë, përpiluar nga eksperti Dr. N.F. e datës 02.06.2022, gjykata ka konstatuar faktin se eksperti kishte bërë ekzaminimin e drejtpërdrejtë të këtu paditësit Seb Bullakaj, lidhur me vuajtjet shpirtërore të tij pasi që kishte rënë pre e një mashtrimi për kontratë pune në Gjermani. Eksperti pas ekzaminimit të paditësit ka dhënë mendimin që cenimi i integritetit dhe

autoritetit moral nga mashtrimi ka bërë që paditësi të përjeton dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë për rreth një muaj, dhimbje shpirtërore të intensitetit të mesëm, që ka zgjatur rreth dy muaj dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të ulët, që vazhdon ende në formë të mërzitjes lidhur me moszgjidhjen definitive të dëmit nga mashtrimi.

Nga leximi i ekspertizës nga lëmia financiare e datës 23.03.2023, si dhe plotësimi i saj i datës 22.09.2023, e përpiluar nga eksperti H.B. gjykata konstatoi faktin se eksperti kishte bërë përllogaritjen e fitimit të humbur për paditësin S.B. për shkak të pamundësisë së punësimit të tij në Gjermani, si pasojë e mos sigurimit të vizës dhe lejes së punës së tij. Eksperti gjatë përllogaritjes është bazuar në marrëveshjen me shkrim të kompanisë MNP Personal Leasing, të përfaqësuar nga B.R. të datës 03.12.2016 dhe i njëjti ka ardhur në përfundim se fitimi i humbur për paditësin S.B. i llogaritur për periudhën prej 04.08.2017 kur i është ofruar për nënshkrim kontrata e punës në Gjermani, e deri me datë 30.09.2023, si datë e kryerjes së ekspertizës është shuma në lartësi prej 69,496.08 euro.

### 3. Baza Ligjore

Gjykata vlerëson se në këtë çështje kontestimore gjen zbatim Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve 04/L-007, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012.

Neni 136 i Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD), në par.1 të tij përcakton se: *“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*, neni 137 i po këtij ligji përcakton: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”*, neni 140 i këtij ligji përcakton: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”*.

### 4. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, provat e administruara më lartë në lidhje me këtë çështje kontestimore dhe dispozitat e lartcekura ligjore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar dhe se e njëjta duhet të refuzohet, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ishte kontestuese se paditësi S.B. kishte rënë pre e mashtrimit, me rastin e lidhjes së kontratës për ndërmjetësim punësimi me kompaninë MNP “Personal Leasing” me seli në Prizren, të cilën e përfaqësonte këtu i padituri B.R. për ndërmjetësimin e punës në shtetin e Gjermanisë, e për të cilën i njëjti kishte paguar shumën në lartësi prej 2,500.00 euro. Po ashtu, nuk ishte kontestuese fakti se ndaj të paditurve B.R. dhe F.H. ishte zhvilluar procedura penale për shkak të dyshimit të kryerjes së veprave penale shpërlarje parash nga neni 308 i Kodit Penal, veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 lidhur me nenin 81 të Kodit

Penal dhe i padituri F.H. edhe për veprën penale shmangie nga tatimi nga neni 313 par.3 të Kodit Penal të Kosovës dhe se sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, APS.nr.23/20, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda, me numër PKR.nr.66/2018, i datës 09.02.2020, vetëm në piken II të dispozitivit, për veprën penale të mashtrimit nga neni 335 par.2 dhe nenit 31 dhe 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Kontestuese në këtë çështje kontestimore ishte fakti se përveç dëmit material të cilin paditësi e kishte paguar në lartësi prej 2,500.00 euro, me rastin e lidhjes së marrëveshjes së ndërmjetësimit me MNP Personal Leasing, e për të cilën kërkesë paditësi është tërhequr gjatë zhvillimit të procedurës, për shkak të inicimit të procedurës përmbartimore, a i është shkaktuar edhe dëm tjetër material dhe jo material, si dhe fitim i humbur këtu paditësit S.B. me rastin e nënshkrimit të kontratës për ndërmjetësim punësimi me kompaninë MNP Personal Leasing, si dhe me nënshkrimin e kontratës së punës në mes të paditësit në cilësi të punëmarrësit dhe Capar Spezialtiefbau GmbH, në cilësi të punëdhënësit, sipas të cilës paditësi do të kompensohej nga 14.70 euro në orë pune, me orar të plotë prej 40 orë punë në javë.

Gjykata gjatë vendosjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i vlerësoi pretendimet e paditësit se me rastin e nënshkrimit të kontratës së punës me Capar Spezialtiefbau GmbH, për punën me të cilën do ta realizonte në shtetin e Gjermanisë, e që me fajin e këtu paditësve i njëjti paditësit i është refuzuar viza për punësim, pasi që nuk është plotësuar dokumentacioni, i është bërë cenimi i integritetit personal për shkak të së cilit i njëjti ka pësuar dhimbje shpirtërore, si dhe paditësit ka pësuar edhe fitim të humbur, pretendime të cilat i vlerësoi si të pabazuara.

Paditësi ka theksuar se këtu të paditurit me rastin e veprës penale të mashtrimit, për shkak të cenimit të integritetit të paditësit, të njëjtit i kanë shkaktuar dëm material dhe jo material, duke kërkuar kështu që të njëjtit në mënyrë solidare ti kompensojnë shumën e dëmit në lartësi prej 10.000 euro. Gjykata vlerëson se e Drejta e Integritetit Personal, është një e drejtë e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht në nenin 26 është përcaktuar “E drejta në Integritet Personal”, ku e njëjta ka përcaktuar se: “Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që përfshin: (1) të drejtën që të marrë vendime lidhur me reproduktimin, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj; (2) të drejtën që të ketë kontroll mbi trupin e saj/tij në pajtim me ligjin; (3) të drejtën që të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj në pajtim me ligjin; (4) të drejtën që të mos marrë pjesë në eksperimente mjekësore ose shkencore, pa pëlqimin paraprak të saj/tij”, e që në rastin konkret gjykata vlerëson se nuk kemi të bëjmë me cenimin e integritetit personal të paditësit me veprimet kundërligjore të të paditurve. Përkundër faktit që në këtë çështje është bërë nxjerrja e provës përmes ekspertizës mjeko ligjore nga lëmia e psikiatrisë, mirëpo nga veprimet e të paditurve gjykata vlerëson se nuk kemi të bëjmë me cenim të integritetit personal të këtu paditësit, andaj edhe nuk mund të detyrohen të paditurit që paditësit t’ia kompensojnë

shumën e kërkuar në emër të dëmit jo material. Pra gjykata vlerëson se në rastin konkret paditësit me veprimet e të paditurve nuk i është cenuar integriteti personal i tij, andaj edhe ekspertizës nuk ia fali besimin, pasi që ekspertiza në fjalë paditësit nuk mund të ia vërteton bazën ligjore për fitimin e të drejtës së tij për këtë formë të kompensimit, përkatësisht përmes kësaj ekspertizë janë paraqitur dhimbjet shpirtërore të paditësit, por nuk ka mundur të përcaktohet që paditësit i është cenuar integriteti i tij personal.

Po ashtu gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar edhe kërkesën e paditësit që në emër të fitimit të humbur, të njëjtit ti paguhet shuma në lartësi prej 49,496.08 euro, andaj vendosi që e njëjta duhet refuzohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo pasi që përkundër faktit se paditësi, kërkesën për fitimin e humbur e ka bazuar në ekspertizën financiare të datës 23.03.2023 dhe plotësimin e datës 22.09.2023, të punuar nga eksperti financiar A.B. gjykata vlerësoi se eksperti gjatë përpilimit të kësaj ekspertize dhe dhënien e mendimit të tij është bazuar në marrëveshjen me shkrim me kompaninë MNP Personal Leasing, të përfaqësuar nga i padituri B.R. të datës 03.12.2016, si dhe kontratës për punësim në Kompaninë Gjermane Capra Spezialtiefbau GmbH, sipas të cilës paditësi do të kompensohej nga 14.70 euro në orë pune, me orar të plotë prej 40 orë punë në javë. Kurse bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga Aktgjykimi penal me shenjë PKR.nr.66/2018, i cili është bërë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga data 22.07.2020, në piken II të dispozitivit, sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, APS.nr.23/20, për veprën penale të mashtrimit nga neni 335 par.2 dhe neni 31 dhe 81 të KPRK-së, vërtetohet se këtu të paditurit pikërisht për lidhjen e këtyre marrëveshjeve janë shpallur fajtor në procedurë penale, për shkak të veprës penale të mashtrimit, në të cilën një nga të dëmtuarit është këtu paditësi dhe se për dëmin e shkaktuar në lartësi prej 2,500.00 euro, të cilën paditësi e kishte paguar me rastin e nënshkrimit të kontratës për ndërmjetësim punësimi, me aktgjykimin penal paditësi ka filluar procedurën e përmbarimit. Andaj, gjykata edhe ekspertizës financiare nuk ia fali besimin, pasi që e njëjtë është bazuar në kontrata fiktive, të cilat nuk kanë mundur të krijojnë obligime për këtu palët ndërgjyqëse. Ndërsa paditësi gjykatës nuk i ka prezantuar ndonjë provë materiale me të cilën do të vërtetonte faktin se i njëjti ka qenë në marrëdhënie pune me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate, ose se me rastin e nënshkrimit të kontratës paditësi e kishte humbur vendin e punës që e kishte, apo se i njëjti marrëdhënien e punës në shtetin e Gjermanisë e ka pasur të siguruar por të njëjtën e ka humbur për shkak të këtu paditësve, e në këtë mënyrë i është shkaktuar dëmi material-fitimi i humbur në lartësinë e kërkuar. Andaj nga e gjithë kjo, pala paditëse ka dështuar të provojë se cili ka qenë ai fitim i humbur që i është shkaktuar me rastin e nënshkrimit të kontratës me MNP Personal Leasing.

Në këtë drejtim dhe në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, gjykata ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar edhe se e njëjta duhet të refuzohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për faktin se paditësi me asnjë provë materiale nuk ka arritur ti vërteton pretendimet e tij. Pra nuk janë plotësuar asnjë nga



kushtet për të lindur obligimi i të paditurve për t'i bërë kompensimin e dëmit të pretenduar paditësit.

Si rrjedhojë është vlerësim i kësaj gjykatës se në rastin konkret barra e provës bie mbi palën paditëse, kjo konform nenit 319 paragraf 1 dhe 2 të cilët thonë: *“Secila palë ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, ndërsa *“të provuarit përfshihet në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit”*. Edhe neni 322 paragraf 2 i LPK-së, përcakton se *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*, barra e provës bie mbi palën paditëse, kjo edhe bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla (Narra mihi factum, dabo tibi ius)”* dhe nga kjo rrjedh se pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim, që në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat e bazon pretendimin e saj.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e konstatuar të tërhequr padinë e paditësit S.B. nga fshati .... komuna e Suharekës, ndaj të paditurit V. R. nga Prizreni, duke u bazuar në nenin 261 paragraf 2, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), i cili ka përcaktuar se: *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. ...”*, lidhur me paragrafin 3 të nenit të lartcekur, në të cilin është përcaktuar se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. ...”*. Kjo pasi që me parashtrësën e datës 17.10.2023, e autorizuar e paditësit ka deklaruar se tërhiqet nga padia sa i përket të paditurit të tretë V.R. ndërsa gjykata me datë 19.10.2023, e ka njoftuar të autorizuarin e të paditurit V.R. për tërheqjen e padisë, duke kërkuar që në afat prej 7 ditësh të deklarohet lidhur me veprimin procedural të palës paditëse. Kurse me parashtrësën e datës 23.10.2023, i autorizuari i të paditurit avokat D.N. ka deklaruar se i padituri pajtohet që të tërhiqet padia ndaj të paditurit V.R. duke kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452 par. 1 dhe atë duke e obliguar paditësin i cili gjatë zhvillimit të procedurës është tërhequr nga kërkesa ndaj të paditurit V.R. që t'ia kompensoj shpenzimet procedurale dhe atë: për përgjigje në padi shumë prej 208.00 euro, për përfaqësimin në dy seanca gjyqësore shumë prej 540.80 euro (270.40 x 2), për një seancë të shtyrë shumë prej 135.20 euro dhe për parashtrësën e datës 23.10.2023 shumë prej 208.00 euro, apo shumë e përgjithshme prej 956.80 € (nëntë qind e pesëdhjetë e gjashtë euro, e tetëdhjetë cent). Pjesën tjetër të kërkesës së të autorizuarit të të paditurit V.R. për kompensimin e shpenzimeve për

Numri i lëndës: 2019:195111  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05733149

seancën e datës 13.06.2023 dhe seancën e datës 05.09.2023, gjykata e vlerësoi si të pabazuara, pasi që të njëjtat janë shtyrë pa fajin e këtu paditësit, andaj edhe i njëjti nuk mund të obligohet për kompensimin e tyre.

Nga të cekurat më lartë dhe bazuar në nenet 136, 137 dhe 140 të LMD-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.1381/2019, datë 24 maj 2024**

**G j y q t a r i**

---

**Shyqri Hoxha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.